

Edmond Vanglel Budo lindur dhe banues në Tiranë më 02.10.1949.

Arsimi: Kam studiuar në Fakultetin e Shkencave të Natyres dhe jam diplomuar: Mesues Matematike për Shkollat e Mesme, ne vitin 1971. Në vitin 1983 kam kryer kursin 1 vjeçar pasuniversitar për Informatikë. Gjithashtu kam dhënë provimin e gjuhës angleze.

Puna: Punën si mësues e kam nisur në Orosh të Mirditës dhe e përfundova në Gjimnazin “ Ibrahim Rugova” Kamzë- Tiranë “ në vitin 2015, vit në të cilin dola në pension. Nga viti 1983 deri ne vitin 1999 jam shkëputur nga arsimi dhe kam punuar si Matematikan pranë Ndërmarrjes NPA.Nr. 1 Tiranë.

Hobi : Filatelia. Me filateli kam filluar të merrem ne vitin 1977 dhe vazhdoj dhe sot e kësaj dite të koleksionoj pullën shqiptare. Në vitin 2012 me nxenesit e mi të Gjimnazit krijova “ Klubin filatelik ” me aktivitet modest deri sa dola në pension. Në vitin 1992 u anëtarësova në Federatën e Koleksionistëve të Shqiperisë. Në vitin 1997 u zgjedha ne kryesinë e saj me detyrë Sekretar dhe financier për 25 vjet me rradhë pa shpërblim deri në Janar 2023. Kam fituar mjaft experencë dhe di të punoj në grup .

Radioamatorizmi. Certifikatën e provimit radioamator Nr. 28 Klasa B e kam marrë në Qershor të vitit 1992, si dhe Liçensën përkatëse me shenjë thirrje ZA1U. Liçensën në MORS e morra tani së fundmi Nga viti 2007 deri ne vitin 2015 se bashku me Z.Lazer Pistulli ZA1V kam ndjekur shumë veprimtari ndërkombëtare në fushën e Radioamatorizmit pa sponsorizim: Kampionati i II ARDF Maqedoni, Kampionati i III Ballkanik ARDF Leskovac- Serbi, Kampionati I IV Ballkanik Tergoviste- Rumani, 2011 ne kampionatin e XVIII të Rajonit të IARU-1 në Baile Felix Rumani etj. Me interes ishte veçanërisht pjesëmarrja si visitor në Kampionatin e 9 botëror të IARU ne HST 2011 si dhe në Kampionatin e 10 botëror të IARU në Beatenberg në Zvicër ku zura vendin e 16.

Njohja dhe transmetimi i ketyre programeve tek radioamatorët e tjerë dha shkas që Z,Fatos Demeti ZA1F të aktivizojë dhe ngrejë nivelin e Radioamatorizmit në arritjet e sotme.